



INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

Prishtinë: 23/07/2026

NJOFTIM PËR PUBLIKUN

Lidhur me situatën meteorologjike dhe përditësimin e parashikimit të motit 20-22.07.2026

Në aspektin sinoptik, sistemi konvektiv u zhvillua fillimisht mbi pjesë të Alpeve Dinarike dhe Bosnjë-Hercegovinës, duke u zhvendosur më pas drejt Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës, Mqedoni së së Veriut etj i shtyrë nga qarkullimi atmosferik në shtresat e mesme të troposferës. Në territorin e Kosovës, relievi malor (Bjeshkët e Nemuna, Sharri dhe masivet e tjera) ndikuan në forcimin lokal të ngritjes së ajrit, duke intensifikuar stuhitë në disa rajone.

Kështu stuhia e ndodhur gjatë datave 20 dhe 21 korrik 2026, nuk ishte një fenomen i izoluar lokal, por pjesë e një sistemi konvektiv që u zhvillua mbi Evropën Juglindore dhe u zhvendos drejt Kosovës, ku u fuqizua nga kushtet lokale të relievit dhe paqëndrueshmërisë atmosferike. Kjo stuhi u karakterizuan nga erëra të forta me rrebeshe shiu, shkarkime elektrike (rrufe), reshje dhe në disa zona, breshër.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës aktualisht i ka 24 Stacione Automatike Meteorologjike, të shpërndara në tërë Kosovën të cilat e bëjnë regjistrimin e një numri të parametrave meteorologjik. Të dhënat e këtyre parametrave regjistrohen në interval ç'do 1/h ndërsa shpejtësia dhe drejtimi i erës ç'do 2/min. Po ashtu IHMK, përdorë një numër të modeleve për parashikime meteorologjike dhe të përmbytjeve etj. IHMK është antarë dhe bashkëpunues me institucione të ndryshme ndërkombëtare siq janë EUMETNET, EFAS etj, andaj parashikimi i një stuhie bazohet në standarde dhe udhëzime të përcaktuara nga Organizata Botërore Meteorologjike (WMO), si dhe institucionet kredibile ndërkombëtare.

Sipas matjeve nga Rrjetit Shtetëror Meteorologjik, në disa stacione u regjistruan rastisje maksimale të erës që arritën kategorinë “Stuhi” sipas Shkallës së Beaufort-it. Intensiteti i reshjeve shkaktoi vërshime të shpejta lokale në disa vendbanime, ndërsa erërat e fuqishme shkaktuan dëmtime të pemëve, infrastrukturës dhe ndërprerje të përkohshme të furnizimit me energji elektrike në disa zona si dhe dëmet në disa kultura bujqësore


Këto ngjarje meteorologjike janë tipike për periudhën verore, kur temperaturat e larta dhe paqëndrueshmëria atmosferike favorizojnë formimin e stuhive të forta konvektive.

Rastisja e erës dhe reshjet e shiut nëpër disa Stacione Automatike Meteorologjike të Kosovës¹

	Stacionet Meteorologjike	L.m.n.d.A	Era		20-21/07/2026	Koha	Reshjet
			m/s	Km/h			
1	Prishtinë	573	11.1	40.0	20/07/2026	16:32	15.6
2	Mitrovicë	500	16.6	59.8	20/07/2026	15:54	9.6
3	Gjakovë	467	13.8	49.7	21/07/2026	16:32	1.5
4	Ferizaj	578	15.2	54.7	21/07/2026	16:44	19.7
5	Kamenicë	474	12.2	43.9	20/07/2026	16:59	8.9
6	Dragash	1048	9.5	34.2	22/07/2026	11:15	0.6
7	Malishevë	556	18.7	67.3	21/07/2026	16:20	23.9
8	Komoran	586	11.5	41.4	20/07/2026	16:36	18
9	Shajkoc	713	16.1	58.0	20/07/2026	16:16	22
10	Bajgorë	1.560	28.2	101.5	20/07/2026	18:08	26.7
11	Rahovec	384	12.2	43.9	21/07/2026	16:44	3.1
12	Skenderaj	676	11.9	42.8	20/07/2026	16:16	25.9
13	Suharekë	411	23.8	85.7	21/07/2026	16:24	1.5
14	Leposaviç	455	11.3	40.7	20/07/2026	15:40	29.1
15	Brezovicë	916	10.1	36.4	21/07/2026	16:44	2.1
16	Hani Elezit	377	18.3	65.9	21/07/2026	16:54	22.9
17	Istog	464	22.3	80.3	20/07/2026	18:08	29.9
18	Klinë	378	12.9	46.4	21/07/2026	16:02	18.6
19	Tugjeç	1.042	22.1	79.6	20/07/2026	16:46	—

Rastisja maksimale prej 28.2 m/s (101.5 km/h) është regjistruar në Stacionin Meteorologjik në Bajgorë dhe kategorizohet si: “Stuhi e ngjashme me shtërngatat”, pastaj në Suharekë 23.8 m/s (85.7 Km/h), Istog 22.3 (80 Km/h), kategorizohen si “Stuhi”

Situata meteorologjike gjate periudhës së stuhive



Standardet e parashikimit të motit:

- Parashikimi afatshkurtër: 0–3 ditë – 72 orë (Shumë i saktë), përdoret për motin ditor (shi, temperatura, erë dhe është standard për parashikimet publike)
- Parashikimi afatmesëm: 4–7 ditë (Saktësi mesatare), modelet me shkallë të gjerë të motit (vala të nxehti, fronte të ftohta) zakonisht parashikohen mirë

¹ Shpejtësitë mesatare të erës korrespondojnë me lartësinë standarde prej 10 metrash mbi tokë të sheshtë dhe të hapur të erëmatësit.

- Parashikimi i zgjatur: 8–14 ditë (Saktësi e ulët për detaje), jepen vetëm tendenca, jo kushte të sakta (p.sh. “më ngrohtë se mesatarja”)
- Afatgjatë/përspektivë: (jo parashikim i drejtpërdrejtë)
- Javë deri muaj (Bazohet në modele klimatike (El Niño, La Niña), jpet si probabilitet, jo si mot.

Standard shkencor kryesor

- Për shkak se atmosfera është dinamike parashikimi i besueshëm i motit është i kufizuar në rreth 7–10 ditë

IHMK, e bënë rregullisht prashikimin 5 ditorë të motit, si dhe për ditët e vikendit, ndërsa gjatë situatave të rënduara meteorologjike dhe hidrologjike bëhen njoftime dhe përditësime paraprake përmes të cilave njoftohen institucionet, mediat dhe qytetarët.

Nuk ekziston një standard ndërkombëtar (WMO) që përcakton në mënyrë strikte një afat kohor unik (p.sh. "24 orë" ose "48 orë") brenda të cilit një Shërbim Meteorologjik Kombëtar duhet të lëshojë paralajmërimin për çdo ngjarje ekstreme. WMO përcakton parimet dhe kërkesat e cilësisë, ndërsa afatet operationale varen nga lloji i fenomenit dhe nga procedurat kombëtare.

Standardet kryesore për parashikimin e stuhive përfshijnë:

Paqëndrueshmëria atmosferike: vlerësohet përmes ngritjes së shpejtë të ajrit më të nxehtë dhe kontaktit me fronte të ftohta, apo sistemeve të kundërta barike duke krijuar konvergjenca të erërave në të cilat ka ndikim dhe relievi malor i Kosovës duke nxitur zhvillimin e reve kumulonimbuse të cilët sjellin rrëbeshe shiu dhe breshër.

Ndërsa prerja vertikale e erës si dhe ndryshimi i shpejtësisë dhe drejtimit të sajë ndikon në organizimin dhe intensitetin e stuhive.

Monitorimi në kohë reale (Nowcasting) përdor radarët meteorologjikë, imazhet satelitore dhe detektorët e rrufeve për të ndjekur zhvillimin e stuhive minutë pas minute gjë të cilën Kosova akoma nuk e ka në dispozicion.

Kriteret tipike për një stuhi të fortë

Një stuhi konsiderohet e fortë kur pritët ose vërehet një ose më shumë nga këto fenomene:

Erëra me rastisje ≥ 20.8 m/s (75 km/h).

Breshër me diametër ≥ 2 cm.

Reshje shumë intensive që mund të shkaktojnë vërshime të menjëhershme.

Aktivitet i dendur i shkarkimeve elektrike.

Në Evropë, paralajmërimet për dukuri të rrezikshme meteorologjike, përfshirë stuhinë, zakonisht klasifikohen sipas sistemit të ngjyrave (jeshile, e verdhë, portokalli dhe e kuqe), i cili përdoret gjerësisht nga shërbimet meteorologjike kombëtare në kuadër të MeteoAlarm. Nivelet e paralajmërimit përcaktohen nga secili shërbim meteorologjik kombëtar, bazuar në pragjet kombëtare të rrezikut, ndikimin e pritshëm të fenomenit dhe në përputhje me udhëzimet e Organizatës Botërore Meteorologjike (WMO).

Andaj duke u bazuar në të gjitha këto, IHMK, lëshon njoftime për tërë teritorin e Republikës së Kosovës, e në raste specifike edhe për zonat konkrete, andaj edhe kategorizimi i ngjarjeve të tillë me simbole (ngyra) është i bazuar në dinamikën e proceseve si dhe ngjarjeve të pritshme dhe ndikimeve tek njerzit, infrastruktura, mjedisi, kafshët etj. Qdo njoftim i kategorizuar si i tillë e ka një afatë kohorë (ditë-orë), së cilës i referohet.

Gjatë kësaj periudhe, një ngjarje e pritshme me potencial për të shaktuar dëme, shpesh mund të ndryshojë në formë, fuqi dhe efekti i sajë të jetë më i dobët apo me intenzivë, kjo mvaret prej shumë faktorëve andaj për atë vendoset një nivel i alarmit, në mënyrë që ai të jetë i vlefshëm për kohën e dhënë për qdo cep të vendit ngase sipas praktikave meteorologjike dhe hidrologjike ka ndodhur që në pjesën më të madhe të vendit mot të jetë i qëndrueshëm (i nxehet, me diell, pa erëra etj), por një zonë apo lokacion të caktuar qoftë edhe periferik të kemi paqarqitjen e një ngjarje si rrëbeshe shiu, vërshime të shpejta, erë e fuqishme, breshër etj, procese këto aq dinamike sa zhvillohen shumë shpejtë dhe përfundojnë për disa minuta.

Për këtë arsyeje edhe kategorizimi apo njoftimi i kalsifikuar sipas ngjyrave në rastin konkret të suhisë së datës 20 – 21/07/2026, është bërë që njerzit të jenë të informuar për ngjarjet potencialisht të mundëshme për të ndodhur dhe pasojat gjegjësisht efektet që mund të shkaktojnë.

Edhe njoftimi për datë 22/07/2026, i kategorizuar si “i portokallt”, është i bazuar të situatën aktuale meteorologjike e sidomos pritshmëritë që gjatë orëve të para të ditës, atëher kur kushtet meteorologjike dhe në përgjithësi ato atmosferike ishin akoma jo stabile me potencial që lokalisht të shkaktohet ndonjë erë e fuqishme, reshje intenzive etj. Andaj për këtë arsye i referohet ky njoftim kësaj datë.

Jo gjithmonë dhe çdo kund kjo mund të jetë shumë e sakt apo më pakë e saktë, IHMK, është insitucion i vetëm në Kosovë i cili ligjërisht e ka të drejten të bëjë njoftime, paralajmërime, prononcime etj., dhe e mbanë përgjegjësinë, gjatë dhe pas çdo ngjarje me karakter hidrometeorologjik.

Gjatë këtyre ditëve nga portale dhe individ jo kompetent edhe pse raste të izoluara, ka pasur paraqitje publike (media, radio etj) dhe postime, të cilat konsiderohen të dëmshme, jo profesionale, tendencioze dhe jo ligjore, duke shaktuar fillimisht pasiguri, hutë, panikë dhe mos besim në institucione.

IHMK, ashtu siq ka qenë gjithmonë e hapur për publikun dhe mediat, me të cilat ka bashkpunim të shkëlqyer, do të vazhdojë me minisionin e sajë për ti informuar qytetarët në kohë dhe me informacione të sakta dhe sigurta.